



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-78
Datë: 16.02.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. "JCODERS" SH.P.K në Prishtinë akreditohet për periudhën 09.12.2016 deri 31.12.2019 për të ofruar këto kualifikime të validuara në KKK:

1.1. JUNIOR CODERS, Niveli I sipas KKK dhe

1.2. JUNIOR CODERS, Niveli II sipas KKK,

2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

- 2.1 Kontratat me angazhim të pjesshëm të shndërrohen në kontrata trevjeçare;
- 2.2 Të korrigohet dhe përditësohet adresa e vendndodhjes së objektit;
- 2.3 Të ofrohet dëshmi për marrëveshjen me qiradhënësin e objektit;
- 2.4 Të ristrukturohet lista e moduleve të ofruara;
- 2.5 Të ofrohet dëshmi nga buxheti i ndarë për zhvillimin profesional të trajnerëve dhe stafit administrativ;
- 2.6 Të riorganizohen minutat e orës mësimore në aplikacion nga 75 minuta në 60 minuta;
- 2.7 Riorganizimi i sallave mësimore;
- 2.8 Të identifikohen trajnerët nga pjesëmarrësit;
- 2.9 Të realizohet një zyrë e trajnerëve;
- 2.10 Të definohet koha e arkivimit të provimeve, testeve dhe ushtrimeve
- 2.11 Të emërohet staf për sigurim të cilësisë
- 2.12 Riorganizimi i sigurisë në hapësirën e brendshme
- 2.13 Mbrojtja e të dhënave personale

- 2.14 Të zhvillohet procedura për mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe ndarjes së fitimit
- 2.15 Ky kualifikim të ndahet në dy nivele sipas moshave, moshë 7-14 certifikohet me nivelin e parë në KKK si dhe moshë 15-18 certifikohet me nivelin i 2 në KKK. Deri sa moshë 4-6 nuk ka nivel sepse kjo grup moshë nuk ka apo nuk arrin shkathësitë e përcaktuara në nivelin 1 të KKK-së siç janë shkrimi, leximi dhe përdorimi i numrave, kryerja e proceseve themelore me kompjuter, veprimin brenda një strukture të mbikëqyrur apo pune ekipore.
3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datën **01.09.2017**, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si Institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi u dërgohet:

- JCODERS

- AKK.



Bedri Xhafa

Anëtar i KD së AKK-së